

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve Vahid Halili, kryetar, Fillim Skoro, gjyqtar referues e Abdullah Ahmeti, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarve A.H. dhe V.B., nga Prishtina, për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1, nën par.2, pika 2.4 të KPRK, dhe A.M. e N.F., nga Prishtina, për shkak të veprës penale, Mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë, të mbrojtësve të akuzuarve, av.T.B., av. D.R., av.O.H. dhe sipas ankesës së përbashkët të av.A.K. dhe av.G.V., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.362/2016, të dt.15.12.2016, në seancën e Kolegjit të mbajtur me dt.11.04.2017, morri këtë:

AKTGJYKIM

I.Me aprovimin e ankesës të PTH-DKR në Prishtinë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.362/2016, të dt.15.12.2016, sa i përket vendimit për dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarit N.F. për veprën penale Mashtrimi në detyrë,e më afër të përshkruar si në dispozitivin III, të aktgjykimit ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)viteve,e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari, në afatn e verifikimit prej 3(tre)viteve, nuk kryen vepër tjetër penale, dhe urdhërohet i akuzuari, e në bazë të nenit 62 par 2 nën par 2.2 të KPRK, që MKRS tia kompenzoj dëmin e shkaktuar në shumë prej188,000 (njqindë e tetëdhjetë e tetë mijë)Euro, ne afet prej 3(tre)muajve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcimin e ekzekutimit të dhunshëm, në të kundërtën nëse i akuzuari nuk përmbush detyrimin dhe nuk ia kompenzon dëmin e shkaktuar MKRS , dënimi me kusht do të revokohet , të akuzuarit A.M., për veprën penale Mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 të KPK, e më afër të përshkruar si në dispozitivin IV, të aktgjykimit ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1(nji) vit e 6(gjashtë) muaj ,e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari, në afatin e verifikimit pre 3(tre)viteve nuk kryen vepër tjetër penale, dhe urdhërohet i akuzuari, e në bazë të nenit 62 par 2 nën par 2.2 të KPRK, që MKRS tia kompenzoj dëmin e shkaktuar në shumë prej100.000 (njëqindmijë)Euro, ne afet prej 3(tre)muajve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcimin e ekzekutimit të dhunshëm në të kundërtën nëse i akuzuari nuk përmbush detyrimin dhe nuk ia kompenzon dëmin e shkaktuar MKRS dënimi me kusht do të revokohet.

Revokimin e dënimit me kusht të shqiptuar, bashkë me dënimin platësues ndaj të akuzuarve N.F. dhe A.M., do ta procedojë, Gjykata Themelore-DKR në Prishtinë.

II.Me aprovimin e ankesës të mbrojtësit të akuzuarit V.B., av.D.R., e sipas detyrës zyrtare, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.326/2016, të dt.15.12.2016 dhe në bazë të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP,

LIROHET NGA AKUZA

Se si person zyrtar, Ministër në MKRS, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për kompani "Morina Films", ka keqpërdorë pozitën e tij zyrtare dhe ka tejkaluar autorizimet ashtu që me dt.19.09.2008, edhe pse ka pasur dijeni se kontrata e dt.30.01.2007, që kishte lidhur ministri i mëparshëm i MKRS, i pandehuri A.H., ishte e kundërligjshme, ka lidhur aneks kontratë me pronarin e kompanisë së përmendur A.M., e në bazë të së cilës ka marrë vendim për transferimin e mjeteve nga vija investimeve kapitale në atë të subvencioneve dhe në bazë të saj me dt.16.10.2008, nga buxheti i MKRS, i janë pagua kompanisë 100.000,00Euro, duke i siguruar asaj përfitim të kundërligjshëm dhe njëkohësisht duke dëmtuar buxhetin e MKRS, për këtë shumë,-

-me çka kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1, nën par.2, pika 2.4 të KPRK.

Shpenzimet e procedurës penale bijën në barrë të mjeteve buxhetore të asaj gjykate.

III. Me aprovimin e ankesës të mbrojtësit të akuzuarit A.H. dhe të ankesës të akuzuarit A.H., edhe sipas detyrës zyrtare, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.362/2016, të dt.15.12.2016, ashtu që ndaj të akuzuarit A.H., refuzohet akuza, për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1, nën par.2, pika 2.4 të KPRK, e më afër të përshkruar si në dispozitivin I, konform dispozitës së nenit 363 par.1 nën par 1.3 të KPP, lidhur me nenin 107 par.1 dhe 8 të KPRK, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

IV. Në pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pa prekur.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.362/2016, të dt.15.12.2016, të akuzuarit A.H., V.B., janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1, nën par.2, pika 2.4 të KPRK, dhe secilit veç e veç, i janë shqiptuar dënime burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, e të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse në afatin e verifikimit prej 2(dy)vitesh, nuk kryen vepër të re penale, të akuzuarit N.F. dhe A.M., janë shpallur fajtor për veprën penale mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 të KPK, dhe secilit veç e veç, i janë shqiptuar dënime burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, e të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse në afatin e verifikimit prej 2(dy)vitesh, nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit në mënyrë solidare janë obliguar që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor secili prej tyre në shumë prej nga 100Euro.

Të akuzuarit N.F. dhe A.M., të dëmtuarës MKRS, janë obliguar që të ia kompensojnë dëmin e shkaktuar dhe atë i akuzuari N.F., shumë prej 188,000,00Euro, i akuzuari A.M., shumë prej 100.000,00Euro, e në afat jo më të gjatë se 3(tre)muaj, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë e nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë kanë ushtruar ankesa:

- Prokuroria Themelore-DKR, në Prishtinë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën dhe të akuzuarit A.H. dhe V.B., për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1, nën par.2, pika 2.4 të KPRK, dhe të akuzuarit Nehat Fajza dhe A.M., për veprën penale Mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 të KPK, ta ndryshoj aktgjykimin dhe ti shqiptoj dënim me burgim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit A.H., av.T.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të ligjit penal, dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të liroj të akuzuarin A.H. nga akuza konform neni 364 par.1 nën par.1.3 të KPRK apo që aktakuza të refuzohet konformë neni 363 par.1 nën par.1.3 për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

-I akuzuari A.H., për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, me propozim që Gjykata e Apelit të refuzoj akuzën konformë neni 363 par.1 nën par.1.3 të KPP.

-Mbrojtësi i të akuzuarit V.B., av.D.R., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të ligjit penal në dëm të akuzuarit, dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim, që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarin V.B. ta liroj nga akuza, ose aktgjykimin ta anuloj dhe çështjen ta kthej në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim dhe vendim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit N.F., av.O.H., për shkak të për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të ligjit penal në dëm të akuzuarit, dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim, që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarin N.F., ta liroj nga akuza, ose aktgjykimin ta anuloj dhe çështjen ta kthej në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim dhe vendim.

- Mbrojtësit e të akuzuarit A.M., av.G.V. dhe av.A.K., në ankesën e përbashkët për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa dhe aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet dhe i akuzuari A.M., për shkak të mungesës së provave të lirohet nga akuza.

-Prokuroria e Apelit, me shkresën e saj PPA/I.nr.68/2017, të dt.08.02.2017, ka propozuar që: të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore DKR në Prishtinë, të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të akuzuarve në vend të dënimeve të kushtëzuara ti shqipton dënime me burgim efektiv, ndërsa ankesat e mbrojtësve të akuzuarve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPP të Kosovës, nuk caktoji seancën e kolegjit për arsye se nuk kemi të bëjmë me dënime të shqiptuara me burgim.

Gjykata e Apelit duke vepruar sipas ankesave të PTH– DKR në Prishtinë dhe ankesave të mbrojtësve të akuzuarve, A.H., av.T.B. dhe të ankesës së të akuzuarit A.H., të mbrojtësit të akuzuarit V.B., av.D.R., të mbrojtësit të akuzuarit N.F., av.O.H., të ankesës së përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit A.M., av.G.V. dhe A.K., edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK-së, vlerësoji pretendimet ankimore të paraqitura në ankesa, e duke marrë parasysh edhe mendimin e Prokurorisë së Apelit – DKR në Prishtinë dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe gjeti :

Ankesa e PTH – DKR në Prishtinë, ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.H. dhe ankesa e të akuzuarit A.H., si dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit V.B., janë të bazuara, ndërsa ankesat e mbrojtësve të akuzuarve N.F. dhe A.M. refuzohen janë të pabazuara

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Themelore-DKR në Prishtinë, në ankesën e saj pretendon, se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat rënduese, se të akuzuarit janë të arsimuar, të njohur si persona publik, të akuzuarit A.H. dhe V.B., si ministra në R. Kosovës, të cilët kanë drejtuar MRSK, e në kohën kur Kosova ka pasur buxhet të vogël, të akuzuarit N.F. dhe A.M., me vetëdije kanë tejkalluar autorizimet e tyre, ashtu që iu ka mundësuar të akuzuarve Armond Morina, që të lidhë kontratën prej 100.000,00Euro, dhe në bazë të asaj kontrate janë bartë në xhirollogarinë e të akuzuarit shuma e të hollave prej 100.000,00Euro, për filmin “Mysafir në sofër”, i cili film kur nuk është realizuar, edhe i akuzuari N.F. si pronar i kompanisë SHPK “Concoria Pictures”, në mënyrë të kundërligjshme ka përfituar me lidhjen e kontratës në shumë prej 188.000,00Euro, për xhirimin e . filmi i cili nuk është realizuar, duke marrë parasysh edhe peshën e veprës penale të cilën e kanë kryer të akuzuarin e cekur më lartë, është dëmtuar edhe buxheti i Kosovës.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.H., av.T.B. dhe vetë i akuzuari A.H., në ankesat e tyre pretendojnë se dispozitivi i aktgjykimit në pjesën e atakuar për të akuzuarin A.H., është i paqartë dhe në kundërtënieje me vetveten dhe arsyetimin, dhe me asnjë fakt apo provë të paraqitur në shqyrtimin gjyqësor, nuk është vërtetuar drejt se cilat kompetenca, i akuzuari i ka tejkalluar, apo detyra zyrtare nuk i ka përmbushur, dhe me të cilat prova është vërtetuar qëllimi i përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, andaj konsideroj se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe në vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike, e si pasojë është shkel edhe ligji penal në dëm të tij, se nuk është provuar se i akuzuari A.H., të ketë kryer veprën penale dhe në mungesë të provave ka , propozuar që të lirohet nga akuza ose që të refuzohet akuza për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale e në bazë të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPRK.

Mbrojtësi i të akuzuarit V.B., av.D.R., në ankesën e tij pretendon, se në aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, dispozitivi i aktgjykimit nuk përmban fakte dhe prova konkrete që përbëjnë figurën e veprës penale dhe aktgjykimi nuk është në përputhje me nenin 360 par.4 në lidhje me nenin 365 par.1 nën par.1.1 të KPK, gjykata e shkallës së parë, nuk ka vlerësuar sugjerimet e Gjykatës së Apelit edhe pse janë dëgjuar dëshmitarët, ish kryeministrat B.K. dhe A.Ç., gjykata nuk nxjerr konkludim të drejtë lidhur me atë se i akuzuari a e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. I akuzuari me aneks kontratë ku është paguar shuma prej 100.000,00Euro e zhvilluar procedura pranë Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, ku është nxjerr aktgjykimi i formës së prerë C.nr.13/2011, të dt.28.02.2012, e që është administruar si provë. Ankesa pretendon se i akuzuari A.M. si pronar i

kompanisë “Morina films”, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore ka prezantuar MRKS, llogari të rreme si shpenzime për xhirimin e filmit “Mysafir në sofër”, i cili kurrë nuk është realizuar siç përshkruhet në dispozitivin e aktgjykimit, kjo përjashton ekzistimin e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 442 të KPRK, për të akuzuarin V.B.. Gjykata e shkallës së parë nuk jep fakte vendimtare lidhur me veprimet inkriminuese të akuzuarit Valton, lidhur me dashjen si elemente subjektiv i veprës penale, e kjo si rrjedhojë e mungesës së provave se i akuzuari, si ministër në MKRS, producentit A.M. dhe koproducentes-dëshmitares Cheryl Johanson, ka kërkuar përmbushjen e detyrimit ligjor të kësaj ministrie sipas kontratës të lidhur me ddt.30.01.2007, nga ana e të akuzuarit A.H., për mbështetjen e realizimit të filmit “Mysafir në Sofër”, në shumë prej 350,000,00Euro, kjo kontratë asnjëherë nuk është realizuar dhe e njëjta kontratë për realizimin e filmit ka qenë edhe pikë e rendit të ditës në mbledhje të qeverisë dhe ish kryeministrat Barjam Kosumi dhe A.Ç. të cilët e mbështesin realizimin e filmit, dhe i akuzuari bënë alokimin e shumës prej 100.000,00 Euro , sipas aneks kontratës , pas dorëzimit të “Snopit” për filmin “Mysafir në Sofër”, e pasi i akuzuari A.M., nuk ka ndërmarrë veprimet për realizimin e filmit “Mysafir në Sofër”, i akuzuari V.B., ka ndërprerë subvencionet e më tejme sipas kontratës bazë, e të gjitha këto gjykata nuk i ka marrë parasysh, e si pasojë e kësaj është shkelur ligji penal dhe ka kërkuar që ndaj të mbrojturve të tij të merret aktgjykim lirues.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.F., në ankesën e tij pretendon se nuk është sqaruar a kemi të bëjmë me vepër penale apo raport juridiko civile, nuk janë sqaruar se çka nënkupton llogaria e rreme, po ashtu edhe nuk është vlerësuar se a ekzistojnë elementet e posaçme të figurës së veprës penale (dashja dhe përfitimi), dhe nuk është vlerësuar ekspertiza e ekspertit financiar R.B., është anashkaluar konstatimi i ekspertizës financiare nga gjykata e shkallës së parë, e që përbënë element qenësor se a ekziston vepra penale mashtrimi në detyrë nga neni 341 par.3 të KPK. Gjykata nuk ka marrë parasysh natyrën e shpenzimeve të paraqitura nga SHPK “Concoria Pictures”, se filmi është realizuar në gjashtë shtete ku janë shpenzimet e ushqimit dhe veshjeve etj, nga kjo rrjedh se i akuzuari N.F., nuk ka prezantuar llogari të rreme siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë, në këtë çështje penale nuk ka sqaruar se subvencionet ti nënshtrohen procedurave të tenderimit, e nga kjo rrjedh përfundimi se kemi marrëdhënie juridiko civile. Aktgjykimi i ankimuar është përpiluar në kundërshtim me dispozitën e nenit 365 par.1 të KPP dhe gjykata nuk ka dhënë lidhur me faktet vendimtare siç parasheh dispozitave e nenit 370 par.6 dhe 7 të KPP: si pasojë e të gjitha këtyre, edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe detyrimet kontraktuale në mes palëve janë paraqitur si veprime inkriminuese, e përveç kësaj nuk janë vlerësuar detyrimet e ministrisë e cila ka qenë e obliguar që projektet ti mbikëqyr vazhdimisht dhe bashkërisht, e në përkujdesjen dhe realizimin e tyre sipas kushteve të kontratës. si pasojë e këtyre shkeljeve të cekura më lartë është shkelur ligji penal në dëm të abuzuarit N.F., nga neni 385 par.1 të KPP, pasi që me asnjë provë nuk janë manifestuar elementet e veprës penale të cilat i vihen në barrë dhe gjykata vetëm ka përshkruar dispozitën ligjore. Meqë aktgjykimi është përfshirë me shkelje esenciale të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, edhe sanksioni penal nuk është i arsyeshëm dhe i drejtë, e aq më parë që i akuzuari të obligohet për kthimin e një detyrimi i cili është i kontestueshëm. Si përfundim ankesa thirret në parimin “indubio pro reo”, që ka kërkuar që në rastet e dyshimtar ligji interpretohet në favor të akuzuarit.

Mbrojtësit e të akuzuarit A.M., në ankesën e përbashkët pretendojnë se aktgjykimi përmban shkelje esenciale nga neni 384 par.1 nën par 1.12 lidhur me nenin 370 par 6 dhe 7 të KPP. Sipas nenit 360 par.6 gjykata nuk ka dhënë arsye të qarta dhe të plota dhe gjykata nuk ka paraqitur arsyet për secilën pikë të veçantë të aktgjykimit.. Gjykata nu ka dhënë fakte të qarta për llogari të rreme për xhirimin e filmit “Mysafir në sofër”, që kurrë nuk është realizuar duke përfituar shumën prej 100,000,00Euro edhe pse dhe ekspertiza ka arsyetua shumën prej 94,128,00Euro dhe gjykata nuk ka mundur të “dallop realizimin e një filmi dhe xhirimin e një filmi”, për arsye se xhirimi vjen pasi të përfundojnë të gjitha punët përgatitore e të cilat ndryshe quhen faza e para produktionit. Gjykata

nuk i është përmbajtur identitetit objektiv i në mes të akuzës dhe aktgjykimit si parasheh dispozita e nenit 360 par.1 të KPP.. Si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave dhe proceduarve penale është shkëlur edhe ligji penal, kjo për arsye se në aktgjykim mungon elementi konstitutiv i veprës penale se i akuzuari a ka statusin e personit zyrtar, a ka qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore dhe a bënë prezantime të rreme të raporteve e llogarive. Gjykata nuk ka arritur të vërtetojë se i akuzuari A.M. ka bërë prezantimin e rreme të raporti të llogarive, dhe kemi të bëjmë tërësisht me kualifikim të gabuar të veprës penale dhe nuk është përmbushur elementi i posaçëm i figurës së veprës penale mashtrimi në detyrë. Ankesa perëndon se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë kjo për arsye se i akuzuari ka zhvilluar takime të panumërta, ka bërë përzgjedhjen e lokacioneve ka realizuar dhe përmbyllur projektin e skenarit, ka bërë planin e detajuar të xhirimeve, ka realizuar marrëveshjen me aktoren kryesore dhe ka pasur kontrata të lidhura me hotele dhe restorante, të gjitha këto veprime kanë pasur koston e vet, e të cilat i akuzuari i ka prezantuar në Ministrinë përkatëse, e të gjitha këto i ka vërtetuar me anë të faturave dhe është realizuar shuma prej 94.128,00Euro, të cilat i ka vërtetuar edhe eksperti financiar R.B..

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit N.F. dhe në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.M., e sipas detyrës zyrtare në kuptim të ekzistimit shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare se i akuzuarit, janë kryes të veprës penale për të cilat janë shpall fajtor.

Aktgjykimi i ankimuar, është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 365 par.1 të KPP, në aktgjykim janë paraqitur të gjitha faktet dhe rrethanat e të cilat përbëjnë figurën e veprave penale për të cilat e për vepra , të akuzuarit janë shpall fajtor , e në bazë të provave të nxjerra në shqyrtimin gjyqësor dhe me vlerësimin e drejtë të tyre gjykata ka nxjerr përfundime të drejta dhe të qarta lidhur me faktet vendimtare se akuzuarit N.F. dhe A.M. janë fajtor për kryerjen e veprave penale mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 të KPK.

Pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve, se edhe me ekspertizë financiare janë arsyetuar mjetet se kompania "Morina Films", ka arsyetuar shumën prej 94,128 euro të cilat, në emër të shpenzimeve për udhëtime, derivate , reprezentime, telefona e akomodime apo honorarë janë shpenzime të cilat i ka krijuar A.M., e duke u nisur nga fakti se për realizimin e filmit "Mysafir në Sofër" është dashur që për këtë projekt sigurimi 5,000.000.00 Euro (pesë milion) Euro , i akuzuari Armond ka qenë i vetëdijshëm se një shumë e tillë nuk ka mundur të sigurohet andaj si konkludim i kësaj, i akuzuari Armond ka mundur të dijë për veprimet e tija një projekt i këtillë është i pa realizueshëm, mjetet financiare të cilat i ka marrë nga MKRS- së, sipas kontratës bazë, e të cilat janë paguar të akuzuarit me aneks kontratë për realizimin e filmit "Mysafir në Sofër" në shumë prej 100.000 Euro, të njëjtat mjete janë shpenzuara nga i akuzuari dhe faktuarat e paraqitura në ekspertizë, janë frakturat të cilat i ka krijuar vetë i akuzuari Armond duke shpenzuar paranë publike në mënyrë jo racionale e i vetëdijshëm se realizimi i filmit "Mysafir në Sofër", e që kap shumën prej 5,000.000.00 (pesë milion) Euro është i pa realizueshëm, ndërsa sa i përket filmit "Power Cuts", i njëjti është realizuar me vonesë dhe si i tillë, në vend të filmit për të cilin janë dhënë mjete financiare MKRS-së . në kinemanë ABC në vend të filmit "Power Cuts", është shfaqur, premiera e filmit , "Në Kërkim të Larës", dhe ekspertiza e kryer për projektin e kryer filmit "Power Cuts", shpenzimet e paraqitura e të arsyetuara sipas ekspertizës, nuk paraqesin shpenzimet nga mjetet të cilat si mbështetje për realizimin e filmit "Power Cuts", janë alokuar në SHPK "Concoria Pictures", e cila firmë është regjistruar në emër të akuzuarit N.F..

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit N.F. dhe në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.M. se të akuzuarit nuk janë persona zyrtar, janë të pa qëndrueshme, kjo për arsye se sipas dispozitës së nenit 120 par.2 të KPRK, është parashikuar se shprehja “person zyrtar”, nënkupton “personin e zgjedhur ose të emëruar nga një organ shtetëror, person i autorizuar në një organ shtetëror, organizatë biznesi ose ndonjë pëson juridik e i cili sipas ligjit apo ndonjë dispozite tjetër të nxjerr në pajtim me ligjin ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj, ndërsa sipas nenit par.2.2, person përgjegjës sipas par.5 është personi fizik në kuadër të personit juridik, të cilit i janë besuar detyra të caktuara ose i cili është i autorizuar për të vepruar në emër të personit juridik dhe ndërlidhja me par.2 të nenit 120 kur bëhet fjalë për organizatë biznesi, e i akuzuari N.F., është pronar i SHPK “Concoria Pictures”, ndërsa i akuzuari A.M., është pronar i kompanisë “Morina films”, kjo pa dyshim nënkupton se në organizatat e tyre të biznesit e të cilat janë regjistruar në organin shtetëror si persona juridik, kanë statusin e plotë të personit përgjegjës, e në favor të përfundimit të kësaj që të akuzuarit janë persona përgjegjës kjo mbështetet edhe nga çertifikata e biznesit se të akuzuarit janë regjistruar në regjistrin e biznesit në organin kompetent, kompania “Morina films”, është regjistruar si biznes individual, pronari i së cilës është i akuzuari A.M., ndërsa SHPK “Concoria Pictures”, është regjistruar në cilësinë si shoqëri me përgjithësi të kufizuar pronari i së cilës i akuzuari N.F., dhe këto të cekura më lartë paraqesin faktet vendimtare se të akuzuarit janë persona përgjegjës në kuptim të nenit 120 par 2 nen 2.2, e në lidhje me par 5, e kjo është rregulluar në me par 1 nen par 2 lidhur me par 2 e në lidhje me para 5 e në mënyrë identike është rregulluar edhe me KPK(i vjetri) me nenin 107 par 1 nën par 2 lidhur me par 5, si dhe me Ligjin për Shoqërinë Tregtare se si person i autorizuar “ka kuptimin për ndërmarrjet individual, të paraparë si në nenin 13 par 4 pika nen (C),e kjo ka të bëjë me të akuzuarin N.F. se është person përgjegjës, ndërsa sipas nenit 13 par 4 pika nën(i) lidhur me nenin 2 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, person i autorizuar i kompanive është themeluesi ose njëri nga themeluesit e kjo ka të bëjë me të akuzuarin A.M., e që veprimet e tyre inkriminuese lidhur me përgjegjësin penal-juridike përputhet me dispozitën e veprës penale të Mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 të KPK.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare se i akuzuari N.F., me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në vend të filmit “Power Cuts”, ka paraqitur filmin në kinemanë ABC, “Në Kërkim të Larës”, e me qëllim që subvencionin të cilin e kishte marrë nga MKRS, ta arsyetojë dhe në këtë mënyrë bënë prezantimin e rremë të raportit të llogarive se subvencionin është përdorur për filmin “Power Cuts”. Edhe i akuzuari A.M., vepron në mënyrë të njëjtë si edhe i akuzuari N.F. dhe paraqet llogaritë të rreme ku e arsyeton shumën sipas ekspertit 94,128,00Euro, e të cilat fatura janë harxhuar për veprime të ndryshme e që nuk kanë qenë të natyrës për realizimin e filmit “Mysafir në Sofër”, dhe janë shpenzimet të akomodimit nëpër hotele, të pagesave për hon orare për persona të ndryshëm kinse për realizimin e filmit, edhe pse i akuzuari e ka ditur se për projektin e filmit prej 5.000.000,00Euro, është projekt i pa realizueshëm e nga kjo del përfundimi se subvencionet të cilat i ka marrë nga MKRS në bazë të aneks kontratës, i ka marrë me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për veti.

Nga ajo që u tha më lartë rezulton se pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit A.M. dhe në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit N.F. se aktgjykimi është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPP, janë të pa qëndrueshme.

Pretendimet ankimore se gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, nuk janë të bazuara dhe gjykata e shkallës së parë, drejt ka vërtetuar gjendjen faktike se i akuzuari N.F., me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në vend të filmit “Power Cuts”, ka paraqitur filmin tjetër, në kinemanë ABC, “Në Kërkim të Larës”, e me qëllim që subvencionin të cilin e kishte marrë nga MKRS, ta arsyetojë dhe në këtë mënyrë bënë prezantimin e rremë të raportit të llogarive se

subvencioni është përdorur për filmin “Power Cuts”, edhe i akuzuari A.M., paraqet llogari të rreme ku e arsyeton shumën sipas ekspertit 94,128,00Euro, me anë të faturave të ndryshme të siguruara në hotele, restorante dhe vende tjera, e të cilat fatura janë harxhuar për veprime të ndryshme e që nuk kanë qenë të natyrës për realizimin e filmit “Mysafir në Sofër”, dhe ato shpenzime janë shpenzime jo racionale e të akomodimit nëpër hotele, të pagesave për hon orare për persona të ndryshëm kinse për realizimin e filmit “Mysafir në Sofër”, edhe pse i akuzuari e ka ditur se për projektin e filmit nevojitet shuma prej 5.000.000,00Euro, e i cili projekt paraprakisht ka qenë i pa realizueshëm, e nga kjo del përfundimi se subvencionet të cilat i ka marrë nga MKRS në bazë të aneks kontratës, i ka marrë me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për veti.

Gjykata e shkallës së parë, drejte ka aplikuar Ligjin Penal dhe pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve janë të pabazuara dhe gjykata e shkallës së parë, drejte ka vërtetuar se i akuzuari N.F., ka paraqitur llogari të rreme me paraqitjen e filmit “Në Kërkim të Larës”, në vend të filmit “Power Cuts”, të cilat projekte janë tërësisht me përmbajtje dhe natyrë tjetër në raport me filmin për të cilin ka marrë nga MKRS edhe subvencionin, edhe i akuzuari A.M., paraqet llogari të rreme me shpenzimet e parasë publike në mënyrë jo racionale në hotele, restorante, pagimin e honorarëve dhe shpenzimeve tjera e për të cilat ka siguruar fatura nëpër vendet ku kanë ndej dhe në bazë të këtyre faturave janë arsyetuar kinse shuma prej 94,128,00Euro, e cila shumë është tërësisht fiktive kjo për arsye se për realizimin e projektit të filmit edhe pse ajo ka disa faza shuma e përgjithshme është 5.000,000,00Euro, e cila shumë edhe për rrethanat e shteteve më të zhvilluara është e pa realizueshme, e për këtë i akuzuari ka qenë i vetëdijshëm apo ka mundur të jetë i vetëdijshëm se një projekt i tillë nuk mund të realizohet, e me qëllim që vetit ti sjellë përfitim të kundërligjshëm të dobisë pasurore mundohet që me anë të paraqitjes së llogarive të rreme ti arsyetoj shpenzimet të cilat i ka bërë për filmin “Mysafir në Sofër”. Nga ky rezultat se gjykata e shkallës së parë, drejt ka aplikuar Ligjin Penal, si parasheh dispozita e nenit 385 par.1 të KPP.

Gjykata e Apelit në bazë të nenit 51 dhe 62 par.2 nën.par.2.2, të akuzuarve iu ashpërsoi dënimet e shqiptuara të cilat ishin kushtëzuar nga Gjykata Themelore – DKR në Prishtinë, të cilve iu kishte shqiptuar dënime me burgim në kohëzgjatje prej nga 1 (një) viti, nëse në afatin e verifikimit prej 2(dy)vitesh, nuk kryen vepëra tjera penale , dhe ate të akuzuarit N.F. ia shqiptojë dënimin me burgim prej 2 viteve ndërsa të akuzuarit A.M. ia shqiptojë dënimin me burgim prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, e të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse në afatin e verifikimit prej 3 (tre) viteve nuk do të kryejnë vepra tjera penale.

Gjykata e Apelit bashkë me dënimin e shqiptuar me kusht, të akuzuarit i urdhëroi që MKRS-së t'ia kompenzojnë dënimin e shkaktuar, i akuzuari N.F. në shumë prej 188.000 (njëqindetëdhjetetëmijë) euro, i akuzari A.M. në shumë prej 100.000 (njëqindmijë) euro, e të cilat kompenzime të dëmit të shkaktuar, duhet që të akuzuarit ti paguajnë në afat prej 3 (tre) muajve, pasi që aktgjykimit të merrë formën e prerë.

Nëse të akuzuarit nuk e përmbushin detyrimin që MKRS-së t'ia kompenzojnë dënimin e shkaktuar, dënimi me kusht të shqiptuar me detyrim, në afat prej 3 (tre) muajve i cili është afat detyrues, në pajtim me dispozitën e nenit 54 dënimi i shqiptuar me kusht do t'iu revokohet të akuzuarve, nga ana e Gjykatës Themelore – DKR në Prishtinë, ashtu i akuzuarit N.F. dënimi i shqiptuar me kusht do t'i shëndrrohet me dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, ndërsa të akuzuarit A.M. dënimi i shqiptuar me kusht do t'i shëndrrohet me dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, ndërsa kompenzimet e dëmeve të shkaktuar edhe pas shëndrrimit me burgim efektiv të akuzuarit N.F. dhe A.M., do të mbeten dhe dëmet e shkaktuara do t'ia kompenzojnë MKRS-së.

Gjykata e Apelit ka urdhëruar, nëse të akuzuarit nuk i kompenzojnë dëmet e shkaktuara MKRS-së, Gjykata Themelore – DKR në Prishtinë, me pajtim me dispozitën e nenit 54 dhe 62 par.3 të KPRK, do të fillojë procedurën e revokimit të dënimit me kusht ndaj të akuzuarve .

Gjykata e Apelit duke e vlerësuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin dhe pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore-DKR, Gjykata e shkallës së parë i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësues të cilat i ka marr për bazë me rastin e caktimit dhe lartësisë së dënimit ndërsa rrethanat rënduese nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë, e në pajtim me rregullat e përgjithshme mbi matjen e dënimit nga neni 73 të KPRK (i vjetri 64 të KPK), gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të duhur peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë, sjelljet e të akuzuarve, kjo për arsye se të akuzuarit në një nivel të profesionalizmit të tyre dhe personalitetit të tyre, e të cilat ata i posedojnë, e duke ditur se veprimet e tyre nuk janë në harmoni me normat pozitive, ndërmarrin veprimet që janë në kundërshtim me normat e shoqërisë dhe dënimet e shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë, secilit në kohëzgjatje prej nga 1(një)viti, e të kushtëzuara, nuk janë në koherencë me veprimet e të akuzuarve, përgjegjësinë penalo juridike të tyre dhe peshën e veprës penale, e sidomos dënimet e këtilla të kushtëzuara e të shqiptuara të akuzuarve nuk janë në përpjesëtim me rregullat e përgjithshme mbi matjen e dënimit dhe të rrethanave për shqiptimin e dënimeve me kusht të akuzuarve dhe nisur nga kjo Gjykata e Apelit, e ndryshoi aktgjykimin dhe të akuzuarit A.M., ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1(nji) vit e 6(gjashtë) muaj ,e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari, në afatin e verifikimit prej 3(tre)viteve nuk kryen vepër tjetër penale, dhe urdhërohet i akuzuari, e në bazë të nenit 62 par 2 nën par 2.2 të KPRK, që MKRS tja kompenzoj dëmin e shkaktuar në shumë prej 100.000 (njiqindmijë)Euro, ndërsa të akuzuarit N.F., ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)viteve,e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari, në afatin e verifikimit prej 3(tre)viteve, nuk kryen vepër tjetër penale, dhe urdhërohet i akuzuari, e në bazë të nenit 62 par 2 nën par 2.2 të KPRK, që MKRS tja kompenzoj dëmin e shkaktuar në shumë prej 188,000,(njiqind e tetëdhjetë e tetë mijë)Euro, e nga ajo se të dy të akuzuarit parane publike të cilat i kanë marrë sipas subvencioneve i kanë shpenzuar në mënyrë jo racionale dhe sipas bindjes së Gjykatës së Apelit, dënimet e shqiptuara e të cilat janë kushtëzuar edhe me shqiptimin e dënimeve plotësuese ndaj dy të akuzuarve iu janë shqiptuar edhe për arsye se prej kryerjes së veprave penale e gjer në vendosje e saj ka kaluar një kohë e gjatë, dhe dënimi i kushtëzuar me dënimin plotësues te ata do të ndikoj pozitivisht që në të ardhmen të mos kryejnë vepra penale të tilla apo të ngjashme , preventiva individuale, dhe që edhe të tjerët të përmbahen nga kryerja e veprave të tilla penale, preventiva e përgjithshme e që të dyja kanë për qëllim parandalimin e këtyre veprave penale dhe pritjet që të arrihet edhe ndëshkimi i dënimit i paraparë si në nenin 41 të KPRK.

Sipas vlerësimit të Gjykata së Apelit pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit V.B., si ministër në MKRS në Qeverinë e Kosovës në mënyrë të besueshme është vërtetuar se në format e parapara ligjore, si person zyrtar si ministër në MKRS në Qeverinë e Kosovës, nuk e Keqpërdor i pozitën apo autoritetit zyrtar si paraparë në dispozitën e nenit 422 par.1 lidhur me par.2 nën par. 2.4,të KPRK ,dhe i akuzuari nuk i ka shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare apo autoritetin zyrtar, me tejkalimin e kompetencave të t'ia zyrtare, ose në mos përmbushjen e detyrave të t'ia zyrtare, e në format dhe veprimet e parapara ligjore, si rezulton nga shkresat e lëndë dhe nga provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale nuk ekziston qëllimi (dashja), për përfitimin e dobisë pasurore për veti.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk ekziston përfitimi i dobisë pasurore, kjo për arsye së i akuzuari A.H. si ministër MKRS me dt. 20.01.2007 lidhë kontratën me pronarin e kompanisë "Morina Films", - me të akuzuarin A.M. për subvencionimin e filmit "Mysafir në Sofër" dhe në veprimet e kundërligjshme të akuzuarit Valton vlera e subvencionimit të filmit "Mysafir në Sofër në vlerë prej 350.000 Euro nuk ekzistojnë, meqë kontrata e lidhur nga ish ministri A.H., e cila kontratë

nuk ka qen e realizuar. I akuzuari V.B. si ministër i MKRS-së në qeverinë e Kosovës ne mandatin e tij, e në bazë të asaj se i akuzuari A.M. kërkoj implementimin e kontratës, pas dorëzimit të skenarit të filmit “Mysafir në Sofër” e cila është protokoluar ne ministri, me nr. 2677/2008, 19.09.2008, është lidhur aneks kontratën me producentin e filmit “Morina Films”, të akuzuarin A.M. dhe ne xhirollogarinë e tij është lejua pagesa e kështit prej 100.000. Euro , e meqë i akuzuari A.M. nuk vepron sipas fazave të aneks kontratës, i akuzuari V.B. formon komisionin për arsye se i akuzuari A.M. nuk ka prezantuar asnjë raport, dhe pas marrjes së raportit nga ana e komisionit i akuzuari Valton e ndërprejnë financimin e fazave të tjera të projektit të filmit “Mysafir në Sofër”, dhe ngrit padinë pranë Gjykatës Ekomomike , dhe i akuzuari A.M. sipas aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë C.nr.13/2011 të dt.28.02.2012, i cili aktgjykim është i formës së prerë, të paditurin “Morina Films”, pronë e të cilit është kompania i akuzuarit A.M. është detyruar që t’ia kthej MKRS shumë e alokuar të hollave për subvencionimin e filmit “Mysafir në Sofër”.

Në mbështetje të kësaj qëndron fakti së edhe dy ish-kryeministra B.K. dhe A.Ç. në mandatin qeverive të Kosovës , e në kohën kur ministra në MKRS kanë qenë A.H. dhe V.B. kanë përkrahur dhe kanë mbështetur filmin “Mysafir në Sofër”, për arsye se filmi “Mysafir në Sofër”, e ka trajtuar luftën e bërë ne Kosovë, që ishte me interes të veçantë për kulturën e Kosovës, se i akuzuari nuk është kryerës i veprës penale për të cilën është i shpallur fajtor, kjo mbështete edhe në Ligjin mbi Prokurimin Publik, dhe nenin 4.2 të Ligjit të cekur më lartë, është paraparë subvencionet, se nëse 50% ose më shumë e vlerës së çmuar të kontratës së tillë, është qoftë drejtpërdrejtë e subvencionuar nga autoriteti kontraktues apo i financuar me fonde publike në ato raste zbatohet Ligji mbi Prokurimin Publik, në çështjen penale që ka të bëjë me subvencionimin e filmit “Mysafir në sofër”, përqindja është nën 5%, e kjo nënkuptohet se kjo nuk i nënshtrohet fare Ligjit mbi Prokurimin Publik. Të gjitha këto mbështeten në mënyrë të besueshme se deri te ndalja e mëtejme e subvencionimit të filmit “Mysafir në Sofër”, ka ardhë nga mosrealizimi i fazave tjera nga i akuzuari A.M. , dhe nga kjo arsye i akuzuari V.B. urdhron ndërprerjen e mëtejme të financimit të filmit.

Gjykata e Apelit, duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar sipas pretendimeve ankimore të mbrojtësit të akuzuarit edhe detyrës zyrtare në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KPP, e në kuptim të ekzistimit të ndonjë shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit A.H., e në bazë të nenit 385 par.1 nën par.1.3 të KPP, Gjykata e Apelit gjen se aktgjykimi duhet të refuzohet në bazë së nenit 363 par.1 nën par 1.3 të KPP, lidhur me nenin 107 par.1 dhe 8 të KPRK, për shkak të parashkrimit absolut të veprës penale, ndaj të akuzuarit A.H. për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nën par. 2.4 të KPRK.

Me dispozitën ligjore, me të cilën dispozitë ligjorë vepra penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nën par. 2.4 të KPRK, është paraparë se kryesi i veprës penale dënohet me burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet, dhe nga kjo rezulton se procedura penale sipas dispozitës së nenit 106 par.1 nën par. 1.4 të KPK , i cili është i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, për veprat penale të dënueshme më shumë se 3 vjet burgim, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret me kalimin e kohës 5 vjet, duke marr parasysh dispozitën e nenit 107 par.1 të KPRK, se afati i parashkrimit të ndjekjes fillon të rrjedhë nga dita kur është kryer vepra penale, sipas dispozitës së nenit 107 par.8 të KPRK, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Gjykata e Apelit, duke marr parasysh se vepra penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nën par. 2.4 të KPRK, është kryer me dt.30.01 2007, e gjer në vendosjen e kësaj çështje penale kanë kaluar 10 vjet, 1 muaj, e pesë ditë, e kjo nënkupton se kanë kaluar më shumë se 10 vite prej kohës së kryerjes së veprës penale, pra ka kaluar dyfishi i afatit të parashkrimit të veprës penale, siç është rregulluar me dispozitën e nenit 107 par.8 të KPRK.

Në Gjykatën e Apelit, sipas procedurës ankimore lënda penale është pranuar me dt.09..02.2017, e nga kjo rezulton se kjo çështje penale në procedurën ankimore për vendosje në gjykatën e Apelit është pranuar një muaj pasi që është parashkruar lënda , për të akuzuarin A.H., e për veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nën par. 2.4 të KPRK.

Nga se u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në bazë të nenit 403 par1 nën par.1.1 dhe 1.2 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.57/2017 me dt.11.04.2017

Procesmbajtësi,

Eroll Gashi

Anëtarët e Kolegjit

Fillim Skoro

Abdullah Ahmeti

Kryetari i Kolegjit

Vahid Halili